



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

MBI

MBIKËQYRJEN E GRUPIT TË SIGURIMIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 55, datë 26.05.2017

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kushteve dhe kërkesave për realizimin e mbikëqyrjes së grupit të sigurimit, me qëllim administrimin e rrezikut që rrjedh nga ushtrimi i veprimtarisë së grupit të sigurimit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjithë shoqëritë e licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të cilat në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” janë shoqëri mëmë të një grupi sigurimi.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të neneve 140-148, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 4

Mbikëqyrja e grupit të sigurimit

Mbikëqyrja e grupit të sigurimit përfshin vlerësimin dhe kontrollin e të gjitha rreziqeve, kryesisht të:

- a. Strukturës së përgjithshme të grupit të sigurimit;
- b. Sistemit të kontrollit të brendshëm sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje;
- c. Sistemit të administrimit të rreziqeve në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 18, datë 28.04.2015 “Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”;
- d. Rrezikut operacional, strategjik, reputacional dhe ligjor;
- e. Veprimtarive, organizimit dhe drejtimit efektiv të grupit të sigurimit në përputhje me rregulloret e brendshme të tyre;
- f. Strategjive të veprimtarive të biznesit ndërmjet shoqërisë mëmë dhe subjekteve përbërëse të grupit të sigurimit;
- g. Mjedisit të përgjithshëm ku ushtron veprimtaritë shoqëria mëmë, si edhe çdo subjekt përbërës i grupit të sigurimit;
- h. Mjaftueshmërisë, saktësisë dhe transparencës së informacionit;
- i. Mjaftueshmërisë së kapitalit, si dhe të transaksioneve brenda grupit të sigurimit.

Neni 5

Mjaftueshmëria e kapitalit

1. Shoqëria mëmë e një grupi sigurimi duhet të ketë rregullore të qartë të brendshme mbi bazat e vlerësimit, metodat dhe supozimet mbi të dhënat e përdorura për të përcaktuar mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë mëmë të grupit të sigurimit, duke përfshirë detaje, kur është e mundur dhe e përshtatshme, si në vijim:
 - a. Bazat e vlerësimit, supozimet dhe metodat e përdorura për arritjen e vlerës së provigjoneve teknike;
 - b. Një përshkrim mbi të arkëtueshmet nga kontratat risiguruese;
 - c. Bazat e vlerësimit, supozimet dhe metodat e përdorura për të nxjerrë vlerën e detyrimeve të tjera;
 - d. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.
2. Shoqëria mëmë e një grupi sigurimi raporton pasqyrën e “Raportit mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit” në të njëjtat afate kohore dhe forme, sipas përkufizimeve të Ligjit nr. 52/2014 dhe nenit 4 pika 1, gërma c) të Rregullores nr. 34, datë 28.05.2015 “Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”, e ndryshuar.
3. Mjaftueshmëria e kapitalit llogaritet mbi bazën e të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të grupit të sigurimit dhe mbi bazën e kërkesave të nenit 146, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 6

Raportimi i transaksioneve brenda grupit

1. Shoqëria e kontrolluar në një grup sigurimi i raporton Autoritetit për të gjitha transaksionet e rëndësishme brenda grupit, për të cilat është rënë dakord ose të cilat janë kryer ndërmjet shoqërisë së sigurimit dhe personave sipas përcaktimeve të nenit 144, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
2. Këto transaksione duhet të kryhen në përputhje me parimin e administrimit të kujdesshëm dhe të ndërgjegjshëm, duke marrë parasysh interesat e të siguruarve.
3. Shoqëria e kontrolluar raporton:
 - a. Emrin e subjektit përfitues ose dërgues;
 - b. Llojin e transaksionit apo marrëveshjes kontraktuale;
 - c. Datën e transaksionit apo kryerjes së marrëveshjes kontraktuale;
 - d. Vlerën e transaksionit.
4. Shoqëria mëmë dhe e kontrolluar në një grup sigurimi informon menjëherë Autoritetin në lidhje me transaksionet brenda grupit, të cilat rrezikojnë aftësinë paguese të shoqërisë së sigurimit.
5. Raporti vjetor mbi transaksionet brenda grupit depozitohet në Autoritet brenda datës 31 janar të vitit pasardhës.
6. Raportimi pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare kryhet sipas formatit të paraqitur në Aneksin 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
7. Autoriteti, në rastet kur e gjykon të nevojshme, i kërkon shoqërisë mëmë dhe/ose të kontrolluar në një grup sigurimi informacion shtesë në lidhje me transaksionet brenda grupit në formën dhe afatet e përcaktuara prej tij.

Neni 7

Kërkesat raportuese

1. Shoqëria mëmë e një grupi sigurimi, përgatit dhe paraqet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare pasqyrat financiare të konsoliduara të pa audituara brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.
2. Shoqëria mëmë e një grupi sigurimi, përgatit dhe paraqet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare raportimet e kërkuara në zbatim të kësaj rregulloreje, përmbajtja e të cilave përcaktohet në rregulloret përkatëse.

3. Shoqëria mëmë e grupit të sigurimit depoziton në Autoritet një kopje të raportit të auditimit dhe letrën për drejtimin jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës.
4. Shoqëria mëmë e grupit të sigurimit, në plotësim të kërkesës së pikës 2, të nenit 148, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, përgatit një aneks të veçantë të raportit vjetor, duke dhënë të gjitha të dhënat mbi shoqëritë mëmë dhe shoqëritë e kontrolluara të grupit të sigurimit.
5. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë për shoqërinë mëmë dhe/ose shoqërinë e kontrolluar.

Neni 8

Paraqitja e informacionit nga shoqëritë e kontrolluara

1. Shoqëria mëmë siguron që subjektet përbërëse të grupit të sigurimit (shoqëritë e kontrolluara), t’i paraqesin të gjithë informacionin e nevojshëm në zbatim të kërkesave për mbikëqyrjen grupit të sigurimit dhe mbi bazën e tyre, përgatit dhe paraqet në përputhje me detyrimet ligjore dhe rregullatore, raportet dhe informacionet e kërkuara nga ligji “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe nga aktet nënligjore përkatëse.
2. Informacioni i specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni përfshin në veçanti:
 - a. Raportin e kontrollit të brendshëm, raportin e shoqërisë audituese, si edhe planin e biznesit, nëse ekziston;
 - b. Raportet financiare tremujore (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);
 - c. Një listë të aksionerëve ose zotëruesve të interesave pjesëmarrëse dhe të drejtave të tjera;
 - d. Një listë të anëtarëve të këshillit drejtues dhe drejtorisë së shoqërisë së kontrolluar, pavarësinë dhe varësinë e tyre, si edhe anëtarësimi i tyre në këshilla drejtues apo drejtori të subjekteve të tjera, të cilët duhet të përmbushin kërkesat ligjore të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”;
 - e. Shumat e investimeve në aksione, interesa ose instrumenta të tjerë kapitali tek subjekte të tjera, të cilat janë të nevojshme për të llogaritur mjaftueshmërinë e kapitalit ose detyrimet që kanë të bëjnë me kufijtë në pjesëmarrjet influencuese të grupit të sigurimit jashtë sektorit financiar;
 - f. Të dhëna të tjera që shoqëria mëmë kërkon në lidhje me llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi baza të konsoliduara; dhe
 - g. Informacione të tjera, të cilat sipas vlerësimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, mund të jenë të nevojshme për zbatimin e kërkesave për mbikëqyrjen e grupit të sigurimit.

Neni 9

Përmbajtja e raportit mbi strukturën e grupit të sigurimit

1. Raporti mbi strukturën e një grupi sigurimi përmban një listë të subjekteve përbërëse të grupit, të dhëna dhe informacione të veçanta për këto subjekte, si edhe një përshkrim të marrëdhënieve ndërmjet këtyre subjekteve të grupit.
2. Të dhënat dhe informacionet e veçanta për subjektet përbërëse të grupit të sigurimit, përmbajnë minimalisht:
 - a. Emrin e subjektit, numrin unik identifikues (NUIS), veprimtarinë e subjektit dhe totalin e aktiveve;
 - b. Kapitalin aksionar të subjektit, pjesën e kapitalit ose të drejtave të votës që zotëron shoqëria mëmë dhe një listë të subjekteve të tjera që kanë pjesëmarrje në këtë subjekt;
 - c. Administratorët e subjektit dhe të dhëna/informacione nëse këta administratorë kanë pozicione drejtuese në subjekte të tjera;
 - d. Të dhëna/informacione mbi autoritetin përgjegjës për mbikëqyrjen e çdo subjekti në baza individuale, përfshirë edhe subjektet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - e. Të dhëna/informacione mbi auditimet e kryera dhe titullin/emrin e shoqërisë audituese të autorizuar;
 - f. Një listë të transaksioneve më të shpeshta/zakonshme që subjekti kryen me subjektet e tjera përbërëse të grupit të sigurimit; dhe
 - g. Çdo informacion shtesë të nevojshëm për të pasqyruar strukturën e grupit të sigurimit dhe lidhjet në grup.
3. Pjesëmarrjet në kapital ndërmjet subjekteve përbërëse të grupit të sigurimit pasqyrohen në formën e një prezantimi skematik, që tregon qartë pjesëmarrjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në kapitalin ose të të drejtave të votës, ose të kontrollit të përbashkët, ose ndonjë lidhje tjetër, si rrjedhojë e së cilës shoqëria mëmë kontrollon ose ushtron ndikim të rëndësishëm mbi subjektet e tjera përbërëse të grupit të sigurimit.

Neni 10

Afati për paraqitjen e raportit

1. Shoqëria mëmë paraqet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare raportin mbi strukturën e grupit të sigurimit bazuar në të dhënat për situatën në ditën e fundit të çdo viti. Raporti paraqitet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.
2. Shoqëria mëmë, në rast të një kërkesë të veçantë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, paraqet një raport mbi situatën deri në një datë të përcaktuar nga Autoriteti.

Neni 11

Njoftime për ndryshime në grup

Shoqëria mëmë njofton menjëherë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për çdo ndryshim në strukturën e grupit të sigurimit dhe të fakteve të tjera që janë me rëndësi për mbikëqyrjen e grupit të sigurimit.

Neni 12

Sistemi i kontrollit të brendshëm

1. Përgjegjësia përfundimtare për menaxhimin e kujdesshëm të shëndetit financiar të një grupi të sigurimit mbetet tek shoqëria mëmë e grupit të sigurimit.
2. Shoqëria mëmë duhet të sigurojë që grupi i sigurimit mban nivelin dhe cilësinë e duhur të kapitalit në proporcion me tipin, sasinë dhe përqendrimin e rreziqeve me të cilat grupi është ekspozuar.
3. Shoqëria mëmë duhet të sigurojë të ketë sisteme dhe procedura për kontrollin dhe monitorimin e shëndetit financiar në nivel të grupit të sigurimit në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë edhe përputhjen me kërkesat e kësaj rregullorje.
4. Shoqëria mëmë duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin për çdo rrethanë të përkeqësuar që mund të çojë në shkelje të kërkesave të përcaktuara në këtë rregullorje.
5. Shoqëria mëmë e grupit të sigurimit duhet të ketë një përshkrim të qartë se si zbatohet funksioni aktuarial i grupit të sigurimit. Aktuari i autorizuar i shoqërisë mëmë duhet të jetë përgjegjës për të ofruar siguri bordit të drejtorëve të shoqërisë mëmë lidhur me saktësinë e llogaritjeve dhe përshtatshmërinë e supozimeve të përdorura për të përcaktuar kapitalin dhe kërkuar aftësinë paguese në nivelin e grupit të sigurimit.
6. Shoqëria mëmë, me qëllim sigurimin e zbatueshmërisë efektive të kërkesave të kësaj rregullorje dhe në veçanti për sistemin e kontrollit të brendshëm, miraton dhe zbaton akte të brendshme, si dhe sisteme të kontrollit të brendshëm, struktura ose funksione të cilat sigurojnë monitorimin e grupit të sigurimit.
7. Shoqëria mëmë, për auditimin e brendshëm siguron funksionimin dhe pavarësinë e tij për kryerjen e funksioneve të tij me objektivitet.

8. Shoqëria audituese e shoqërisë mëmë duhet të auditojë qëndrueshmërinë financiare¹ të grupit të sigurimit, në përputhje me detyrimet e saj ligjore dhe rregullatore. Shoqëria audituese duhet t'i raportojë bordit të drejtorëve të shoqërisë mëmë dhe Autoritetit çdo çështje që mund të dëmtojë shëndetin financiar të grupit të sigurimit.
9. Shoqëria mëmë duhet të ketë kritere të qarta për sa i përket delegimit të funksioneve sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Neni 13 **Parimet dhe kriteret e vlerësimit**

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vlerëson grupin e sigurimit, në mënyrë të vazhdueshme, duke zbatuar standarde të kujdesshme për të gjitha veprimtaritë e kryera nga grupi i sigurimit.
2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vlerëson strukturën e përgjithshme të grupit të sigurimit për të gjitha veprimtaritë e rëndësishme (duke përfshirë edhe veprimtaritë jo sigurimi) të kryera nga subjektet e tjera të grupit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vlerëson nëse rreziqet e grupit të sigurimit administrohen në mënyrë efektive, si dhe ndërmerr veprime/masa kur rreziqet që rrjedhin nga grupi i sigurimit dhe subjektet e tjera të lidhura me të, në veçanti, rreziku reputacional, ndikon në qëndrueshmërinë e shoqërisë mëmë në Shqipëri.
4. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vlerëson nëse shoqëria mëmë disponon akte të brendshme për drejtimin efektiv, të cilat përfshijnë drejtimin strategjik, mjedisin e kontrollit, strukturën organizative, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe të drejtorëve, si edhe politikat e shpërblimit. Këto akte të brendshme duhet të jenë në përputhje me profilin e rrezikut dhe rëndësinë sistematike të shoqërisë mëmë.
5. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vlerëson nëse aktet e brendshme të shoqërisë mëmë përcaktojnë qartë kërkesat për ekspertizën e nevojshme që duhet të kenë administratorët dhe drejtuesit e lartë të shoqërisë së kontrolluar për të administruar veprimtaritë në një mënyrë të sigurt dhe të shëndoshë, si edhe në përputhje me kërkesat rregullative dhe mbikëqyrëse të vendit të origjinës dhe atij vendas.
6. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vlerëson nëse shoqëria mëmë kontrollon në mënyrë efektive veprimtarinë e subjekteve përbërëse të grupit të sigurimit jashtë territorit të

¹ Ku përfshihen të paktën pasqyrat financiare, mjaftueshmëria e kapitalit, transaksionet në grup, sistemi i kontrollit të brendshëm, etj.

Republikës së Shqipërisë, duke konsideruar profilin e tyre të rrezikut dhe rëndësinë sistematike, si dhe duke siguruar që shoqëria mëmë disponon informacionet e rëndësishme mbi subjektet përbërëse të grupit të sigurimit.

7. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për realizimin e mbikëqyrjes së grupit të sigurimit, mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse vendase ose të huaja.

Neni 14 **Masat mbikëqyrëse**

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse të parashikuara në Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.
2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare merr masa mbikëqyrëse për shoqërinë mëmë në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, në rast se nga aktiviteti i shoqërive të kontrolluara të grupit të sigurimit:
 - a. Cënohet siguria dhe qëndrueshmëria e grupit të sigurimit apo shoqëria mëmë për shkak se veprimtaritë kanë ekspozuar grupin e sigurimit apo shoqërinë mëmë ndaj rreziqeve të tepërta dhe/ose nuk administrohen në mënyrë efektive;
 - b. Bëhet i pamundur ushtrimi i mbikëqyrjes efektive mbi grupin e sigurimit.

Neni 15 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2018.

ANEKS 1

Shoqëria _____

Periudha _____

Raport mbi transaksionet brenda grupit

Vlerat në
Lekë

Emri i subjektit përfitues ose dërgues	Lloji	Nr. i llogarisë	Data e transaksionit, garancisë ose marrëveshjes	Arkëtime	Pagesa
a. Huatë					
b. Garancitë dhe transaksionet jashtë bilancit					
c. Elemente, të cilat përfshihen në llogaritjen e aftësisë paguese					
ç. Investimet					
d. Operacionet e risigurimit dhe retrocedimit					
dh. Marrëveshjet për ndarjen e shpenzimeve					
Totali				0	0

